



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.57, datë 23/09/2005

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË
TIRANËS NR.1, DT.17/02/2005 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.7,
DT.07/03/2003 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
NË QYTETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin Nr.9208, dt.18/03/2004, neni 16, pika 2, 3 dhe 4, neni 32, gërma “f”, ligjit Nr.8982, dt.12/12/2002 “Për sistemin e taksave vendore”, ndryshuar me ligjin Nr.9325, dt.06/12/2004, neni 13, neni 21, neni 22 dhe neni 23, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.1, dt.17/02/2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.7, dt.07/03/2003 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, bëhen këto ndryshime:

I. NË KAPITULLIN 1.1 “TAKSAT VENDORE”, gërma “a.1” “TAKSA MBI NDËRTESEN”,

- Paragrafi i dytë “Afati i vetëdeklarimit për qytetarët” ndryshon dhe riformulohet si më poshtë:

Afati i vetëdeklarimit të pasurisë mbi ndërtesat për qytetarët dhe subjektet fizikë e juridikë është muaji Mars i cdo viti. Vetëm për vitin 2005, për kategorinë “Ndërtesa banimi” afati i vetëdeklarimit nga familjarët është deri më 15 Tetor, ndërsa pagesat të kryhen gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2005.

- Pas paragrafit të dytë të shtohet paragrafi si më poshtë:

Aplikimi i gjobave të bëhet vetëm ndaj familjeve të cilat nuk dorëzojnë formularin e vetëdeklarimit të pasurisë mbi ndërtesën deri më datën 15 tetor 2005.

- Paragrafi “Për vitin 2005, vetëm për kategorinë “Ndërtesa banimi” afati i pagesës së këstit të parë është muaji Shtator 2005 dhe afati i pagesës së këstit të dytë është muaji Nëntor 2005”, shfuqizohet.

III. NË KAPITULLIN 1.1 “TAKSAT VENDORE” mbas gjërmas “ë” “TAKSA E TABELËS” shtohet gjërma “f” me këtë përmbajtje:

f) TAKSA E GJELBËRT (E PËRKOHSHME PËR VITET 2005-2006)

- Pas fjalisë “Afati i shlyerjes së detyrimit është 3-mujori i parë i vitit”, shtohet paragrafi si më poshtë:

Taksa e Gjelbërt për kategorinë e familjarëve është taksë fikse vjetore prej 200 lekë për vitin 2005. Vetëm për këtë vit të ardhurat nga kjo taksë do të arkëtohen nga Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A, gjatë periudhës Tetor - Dhjetor 2005.

IV. NË KAPITULLIN 1.2 “TAKSAT VENDORE”, gjërma “b” “TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE”,

- Paragrafi “Detyrimi vjetor i taksapaguesit për familjarët ndahet.....” ndryshohet si vijon:

Tarifa e pastrimit për kategorinë e familjarëve është tarifë fikse vjetore prej 1000 lekë për vitin 2005. Vetëm për këtë vit të ardhurat nga kjo tarifë do të arkëtohen nga Ujësjiellës – Kanalizime Sh.A, gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2005.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI